

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Nuk ekziston në BE', eksperti: Kamerat e rrugës - Syri Lajmi i fundit
ADRESA	https://www.syri.net/politike/915862/nuk-ekziston-ne-be-eksperti-kamerat-e-rruges-si-ne-vendet-diktatoriale-mbikeqyrje-totale-cenohet-privatesia/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 07:17:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 07:01:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b3452ed61ce24304ed26f340e698b5105aa6d4a13788afb47a84e338fa6299af
TEKSTI	a5177af472d9a654edb3c30a471492229f1b339cb01561490232ecaeb0fda0a
PAMJA	cdfc6136c731f10bb30ab100c7e2d181d89c5ed549eff64f954fa611677c36e7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	45187376ac26b03f34e1dff74eece006be3a973cfb2994cb244faa648694c749
E MËPARSHMJA	fedca518adcbf755d960390aeab7cba0532e8dd9fd3140ed3ada5d2103a22582
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/45187376ac26b03f34e1dff74eece006be3a973cfb2994cb244faa648694c749>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Për ne](#)
- [Redaksia](#)
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)
- [Edicioni i Kosovës](#)
-
- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Op-Ed](#)
 - [Analizë](#)
 - [Blog](#)
- [PLUG](#)
-
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)

toggle menu
 [Ndriçim Kulla Ndriçim Kulla Shogëria shqiptare, duhet të fillojë betejën me heshtjen e SPAK-ut](#)
 [Irena Beqiraj Irena Beqiraj Në Shtetin e Ronit!](#)

-
-
-
-

'Nuk ekziston në BE', eksperti: Kamerate e rrugës, si në vendet diktatoriale, mbikëqyrje totale, cenohet privatësia

ZMADHO TEKSTIN09:01, 11/09/2026



Projekti i ashtuquajtur i qyteteve të zgjuara duket se po fsheh një realitet të zymtë për qytetarët, duke e shndërruar faturën e kripur financiare në një rrezik të përmasave alarmante për privatësinë. Përtej shifrave marramendëse që paguhen, vëmendja po kthehet te përdorimi i kamerave me inteligjencë artificiale që synojnë identifikimin biometrik në kohë reale për çdo individ, një skenar mbikëqyrjeje masive i krahasueshëm me veprën e famshme të George Orwell.

Ekspert për mbrojtjen e të dhënave personale Edrin Fidhe që ishte i ftuar në emisionin e mëngjeist “Kafe Shqeto” në syri tv, e cilësoj këtë nismë jo si një zhvillim teknologjik për të mirën publike, por si një survejim inteligjent që cenon rëndë të drejtat themelore. Kjo teknologji, e cila skanon tiparet biometrike të fytyrës dhe i lidh ato me databazën e Gjendjes Civile, aplikohet sot kryesisht në vende me regjime totalitare ose me demokraci të dobëta, si Kina, Rusia, India dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Ndërkohë, një praktikë e tillë e mbikëqyrjes masive në rrugë apo institucione arsimore nuk gjendet në asnjë shtet të Bashkimit Evropian. Vende si Britania e Madhe e kufizojnë përdorimin e këtyre kamerave vetëm për zona me siguri të lartë apo ushtarake.

Një nga aspektet më tronditëse të këtij projekti mbetet mbledhja e të dhënave biometrike të fëmijëve, duke nisur zbatimin nga shkollat. Kjo përbën një shkelje të hapur të të gjitha kornizave dhe direktivave evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë rregulloren GDPR dhe Aktin Evropian të Inteligjencës Artificiale.

Në një shtet ku skandalet e rrjedhjes së të dhënave personale kanë qenë të njëpasnjëshme, centralizimi i informacioneve biometrike shton frikën e keqpërdorimit të tyre nga palë të treta. Zbatimi i këtij projekti bie në kundërshtim të plotë me aspiratat evropiane të vendit dhe bazën e saj ligjore, tha eksperti.

Flavio Qarri: Sidoqoftë deri në këto momente duket se vëmendjen e ka mbajtur aspekti financiar, për shkak se po paguajmë një faturë sigurisht shumë më të lartë se çdo vend tjetër. Megjithatë gjatë gjithë kësaj kohe shqetësimi yt nuk ka qenë monetar, ti këmbëngul te pjesa që ajo që do të bëhet është shumë më e rëndë se vjedhja. Të lutem më ndihmo edhe për publikun, një sqarim çfarë është Smart City dhe çfarë parashikon nëse implementohet si projekt.

Edrin Fidhe: Tani publiku duhet të kuptojë që Smart City nuk është realisht ajo që thuhet, pra që nënkuptohet nga thjesht emri Smart City. Por është një smart surveillance. Pra është një survejim inteligjent. Do të përdoren kamera të mundësuar nga inteligjenca artificiale. Më në fund e mundësoi këtë gjë, por që pasojat për qytetarët do jenë shumë të rënda. Për sa kohë kjo teknologji çënon drejtpërdrejt privatësinë dhe sigurinë e të dhënave dhe këtë mund ta themi me gojë plot sepse kjo është e provuar. Kemi raste të ngjashme Flavio. Domethënë mjafton të themi që kjo teknologji, pra përdorimi i kamerave me inteligjencë artificiale përdoret në Kinë, Rusi, Indi, Brazil, Emiratet e Bashkuara Arabe, janë të vetmet vende që e aplikojnë dhe këtu vetëkuptohet se çfarë, se çfarë është realisht. Pra vende totalitare, vende që janë mbretëri, pra janë monarki, vende që kanë demokraci të dobët...

Flavio Qarri: Nejshe dhe ne nuk është se e kemi demokracinë aq të fortë.

Edrin Fidhe: Absolutisht, po ne synojmë, ka një dallim të madh. Ne synojmë integrimin në Bashkimin European. Pra ne jemi pjesë e Europës dhe synojmë bashkimin europian dhe duhet të përafrojmë vlerat e bashkimit europian, jo të bëjmë hapa mbrapa.

Flavio Qarri: Në Europë është implementuar kjo si teknologji? Po apo jo?

Edrin Fidhe: Në Europë jo. Le të dalë një përfaqësues i qeverisë shqiptare dhe të thotë në cilin vend të Europës është aplikuar ky projekt në shkolla ose në rrugë. Edhe Anglia që është vendi më iurvejuar, mund ta përdorë kamerat me inteligjencë artificiale por në vende të sigurisë së lartë. Pra në zona ushtarake, në zona që përbëjnë rrezik për sigurinë, rrezik nga terrorizmi e të tjerë e të tjerë, jo në rrugë, jo në mënyrë masive.

Flavio Qarri: Çfarë do të thotë, nëse një kamera me inteligjencë artificiale është në rrugë, çfarë arrin të identifikojë?

Edrin Fidhe: Cilat janë aftësitë e kamerës me inteligjencë artificiale? Një kamera e tillë bën identifikim biometrik në kohë reale. Pra, skanon. Po flasim për aftësitë teknike të kësaj teknologjie. Pra, kjo lloj teknologjie është në gjendje të skanojë biometrinë e fytyrës dhe të bëjë identifikimin e një individi në kohë reale nëse ky sistem është i lidhur me databazat shtetërore siç është databaza e gjendjes civile dhe databaza e të dhënave biometrike, të gjitha këto.

Flavio Qarri: Tani se tash s'është Gysi, është më e rrezikshme...

Edrin Fidhe: Po tani ok, nuk ka rëndësi emri, iku Gysi mund të vijë dikush tjetër më i rëndësishëm se Gysi, ose dikush tjetër që ia di dhe vlerën më mirë të dhënave dhe mund t'i përdorë në mënyra të ndryshme. Pra nuk ka rëndësi kjo, rëndësi ka që në një vend që ka ndodhur skandale pafund me të dhënat personale, tashmë po mblidhen të dhënat biometrike nëpërmjet survejimit masiv. Dhe ka filluar, kjo është më e rënda, me fëmijët. Të cilët gëzojnë një status të veçantë dhe një mbrojtje të veçantë, edhe nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, edhe nga GDPR-i, rregullorja e BE-së, edhe nga AI Act që këta duan ta përafrojnë dhe kanë bërë një projektligj, dhe nga direktiva për sigurinë që është direktiva e 2016 e Bashkimit European, ku kufizohen institucionet e zbatimit të ligjit në mënyrën e përdorimit të teknologjisë AI dhe impaktin që ka te të dhënat personale. Pra baza ligjore në nivel europian është e blinduar te kjo pjesë. Dhe nuk mundet të shkosh më tej duke i përdorur këto teknologji. Pra në qoftë se ne synojmë Bashkimin European, kjo nuk është qasja. Ky është një projekt në kundërshtim me të gjitha, me gjithë bazën ligjore të Bashkimit European.

© SYRInet

Lexo edhe:

-  [Shkrija e bashkisë Klos, inxhinieri: Bashkimi filloj: së pari na hoqën fjalën](#)
-  [Përgjimi i Ahmetajt ka tronditur mazhorancën' Koka: Nufi po kërkon të shpëtojë kokën](#)
-  [Zgjedhja e nënkryetarëve, sot seancë në Kuvendin e Kosovës](#)

Më të lexuarat

[Politikë](#)

[**Sula: PISA 2025 u shënua me yll, OECD e futi Shqipërinë në ‘raportim të kufizuar’, qeveria fshehu të vërtetën**](#)

[Politikë](#)

[**Ju përmend emri në bisedën e Ron Yeffet me biznesmenët ukrainas, gazetari Julian Hoxhaj reagon pas audiopërgjimit**](#)

[Politikë](#)

[**SYRI TV/ Ermal Nufi i ikën si ‘raketë’ pyetjeve të Syri Tv për audiopërgjimin**](#)

[Politikë](#)

[**SYRI TV/ ‘Kufizimi i takimeve të Metës, shqetësim serioz’, Komiteti i Helsinkit letër paraburgimit 313**](#)

[Politikë](#)

[**Noka në 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës: Liria nuk dhurohet, për të duhet luftuar**](#)

[Politikë](#)

[**SYRI TV/ Ngërçi për pagat e gjyqësorit përfundon në dyert e SPAK**](#)

[Politikë](#)

[**SYRI TV/ Debate për audiopërgjimin e Ahmetajt, PD kërkon seanca dëgjimore për aferën**](#)

[Politikë](#)

[**Bardhi: Rama hesht për audiopërgjimin ku miku i tij, Ron Yeffet, flet si i zgjedhur nga qeveria për të bërë punët e saj të këqija**](#)

[Politikë](#)

[**Kryengritja e Postribës, Spahia: Ata u ngritën kundër regjimit komunist dhe u bënë shembull për mbarë Shqipërinë**](#)

[Politikë](#)

[**SYRI TV/ Rama reagon pas kallëzimit ndaj Ministrisë së Financave, kërcënon gjyqtarët dhe prokurorët**](#)

TË NGJASHME

[Politikë](#)

[**‘Qeveria po ndërton ‘Big Brother’-in shqiptar’, Nuri: Kamerat inteligjente shkelin privatësinë**](#)

[Politikë](#)

[**‘Memaliaj nuk duhet të shkrihet’, Brahimi: Reforma territoriale të mos bëhet mbi hartën elektorale**](#)

[Politikë](#)

[Mbyllet protesta e 103-të: Nuk ndalemi deri në largimin e qeverisë Rama](#)

[Politikë](#)

[42 ditë protestë në Divjakë, qytetarët nuk tërhiqen nga revolta e tyre kundër reformës territoriale](#)

[Politikë](#)

[Banorët e Durrësit të ri në protestë, bllokojnë qarkullimin në rrugën Vllazërimi](#)

[Politikë](#)

[VIDEO/ Berisha: Nuk dalim në protestë për të shuar protestën, do të shohim të gjitha variantet](#)

[Politikë](#)

[VIDEO/ Berisha: Protesta është unike, demokratët janë aty çdo ditë. Protestuesit e kanë zhveshur Ramën](#)

- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Arkiva](#)

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

[Denonco](#)

Merrni lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.